



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 594/prot.  
5

Tiranë, më 27. 7. 2023

V E N D I M

Nr. 32, datë 26 .07 .2023

**“Për miratimin e planit të veprimit me qëllim përmbushjen e Rekomandimeve, në zbatim të Vendimit nr. 04, datë 27.01.2023, për “Akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti i Tiranës”, të Bordi të Akreditimit”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, neni 38, pika 1/j, neni 104, pika 4; VKM-së nr. 824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, kriteri 3, Standarti 1.7, Shtojca nr. 1; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 32, pika 2, dhe Vendimin nr. 04, datë 27.01.2023, të Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës,

V E N D O S I:

1. Të miratojë planin e veprimit që do të zbatohet në Universitetin e Tiranës, me qëllim përmbushjen e Rekomandimeve të përcaktuara në Vendimin nr. 04, datë 27.01.2023, për “Akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti i Tiranës”, të Bordit të Akreditimit, të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, sipas tekstit të planit, që shoqëron dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Vendimi, së bashku me planin e veprimit, pjesë përbërëse të tij, të dorëzohet brenda afatit të përcaktuar, pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
3. Ngarkohet Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë për zbatimin e pikës 2, të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

Prof. Dr. Artan Hoxha